

Konkurs kombëtar i arteve pamore për artistët e rinj



IPROMENO

Çmimi

Shkodër
2010



ÇMIMI IDROMENO

2010

Konkurs kombëtar
i arteve pamore
për artistët e rinj

Kurator

Zef Paci

Ekspozita konkurs e nëntorit 2010 është tashmë edicioni i dytë i çmimit Idromeno. Kjo ngjarje artistike që realizohet çdo dy vjet nga Galeria e Arteve nën mbështetjen e Bashkisë së Shkodrës, po përvijohet në një rol informues, dokumentues dhe përhapës të disa prej prurjeve më interesante të artistëve të rinj shqiptarë në fushën e arteve pamore.

Që prej fillimit të këtij aktiviteti, në vitin 2008, Çmimi IDROMENO ka synuar mbështetjen e artit bashkëkohor, artistëve dhe iniciativave të pavarura në Shqipëri dhe krijimin e kushteve më të mira për prodhimin dhe ekspozimin e punëve. Ky aktivitet ka për qëllim të bëhet pjesë e peisazhit kulturor dhe të ndihë rritjen e interesit të publikut për artin bashkëkohor, duke aktivizuar një moment shkëmbimi përvojash në të cilin edhe publiku bashkë me artistët e rinj të jenë pjesëmarrës.

Artan Draçini
Galeria e Arteve e Shkodrës


ÇMIMI IDROMENO 2010: Është organizuar në një mënyrë që pret përtej ndonjë teme të paracaktuar, prurjet dhe prirjet e artistëve të rinj. Ky aktivitet përvijohet si orvatje që reflekton mbi idenë e peisazhit kulturor dhe dëshirën për bashkëkohoren në një vend që mund të ketë shërbyer si frymëzues por jo si një prodhues i saj. Në ndryshim nga disa aktivitete të tjera të organizuara për qëllime marketimi, çmimi IDROMENO ndërtohet vetëm mbi punën e realizuar në mënyrë të pavarur nga artistët e rinj.

Kjo ekspozitë kërkon të çmojë përpjekjet e tyre në një moment kur në Shqipëri ende janë të dukshme ndryshimet e aktiviteteve komerciale me ato jo-komerciale, qofshin publike apo private. Në këtë rast kemi të bëjmë me një aktivitet publik jo-komercial. Kjo zgjedhje është bërë që të presë prurjet që bartin problemet dhe shqetësimet e artistëve të rinj në kohët e sotme duke reaguar kështu edhe kundrejt një instrumentalizimi të artit.

Punët e këtyre artistëve të rinj në këtë edicion të dytë dëshmojnë disa prirje për të analizuar një aktualitet shqiptar dinamik, duke e parë atë edhe në marrëdhëniet që ka me të kaluarën. Është e rëndësishme të ndjehen edhe pikat e pamjes prej nga nisen këto të rinj, të lindur në një kohë dhe kontekst të caktuar historiko-shoqëror. Realiteti ynë po shndërrohet para syve tanë me një shpejtësi e kompleksitet gjer pak më parë të panjohur e të reflektosh mbi të është si të reflektosh mbi një gjendje në lëvizje. Të reflektosh mbi këtë, nëpërmjet një disipline si artet pamore që përherë ka pasur si objektiv njohjen e rileximin e realitetit, është një mënyrë për të mos qëndruar indiferent kundrejt këtyre shndërrimeve dhe të bëhesh pjesëmarrës.

Zef Paci

ARJAN SERJANAJ



Pa titull, audio wave 01:13 min, në loop me sensor, 2009

Audio është marrur nga rrahja e një çekiçi mbi memorjen si një vrimë në hapësirë dhe në kohë.

Puna evidenton një moment të errët, i cili ka rrënjë të thella në memorjen kolektive të shqiptarëve bashkëkohorë, që priirja e sotme na kërkon ta harrojmë, duke e parë si një rievokim të dhimbshëm.

ERVIN BËRXOLLI




Pa titull, fotografi (pinhole), 35 x 32.5 cm



Pa titull, fotografi (pinhole), 90 x 78 cm

Në një epokë të teknologjisë gjithnjë e më komplekse, kjo punë risjell formën më të thjeshtë të kapur në një imazh fotografik. Aparati pinhole është thjeshtë një kuti me një vrimë pa lente, pa pjesë të lëvizshme dhe pa bateri . Shpesh në punën time përfshihet lëvizja dhe ekspozimi i gjatë. Jam më shumë i interesuar ndaj mënyrave alternative të kapjes së imazhit dhe më pak në regjistrimin e "realitetit". Imazhi Pinhole ngelet gjithmonë një proces në zbulim. Mënyra se si objektet mbivendosen dhe shtrembërohen gjatë kohës së ekspozimit është e paparashikueshme. Strukturat arkitektonike janë ulur për të përsëritur elemente grafike ku dizajni i hapsirës është i theksuar dhe e bën atë më surreale. Unë jam i intriguar vazhdimisht nga cilësia narrative që del nga pikat e favorshme të shumta, plus bashkimi i subjekteve në njëri-tjetrin duke krijuar marrëdhënie të çuditshme. Në zakonisht presim një ekspozim të vetëm për të regjistruar një çast të ngrirë të kohës. Pinholi transformon kohën dhe hapsirën duke përfshirë paraqitjen e ekspozimeve të shumfishta brenda një imazhi të vetëm.


GEDMOND LUSHKA



Pa titull, video, 38'15"

Videoja është një monitorim narrativ me nuanca simbolike i ndryshimit të një territori. Ndryshimi ndodh nëpërmjet procesit të shkatërrimit të betonizimit psiko-fizik, përfaqësuar nga një element sa konkret aq edhe alegorik për realitetin tonë si bunkeri. Gjithçka ndodh me veprime jo të shpejta por befasuese që ndërhyjnë here pas here në një proces të gjatë suditjeje.

LEDIA KOSTANDINI



Kukullat roje, fotografi, 80 x 80 cm secila

Në shumicën e rasteve, kukullat janë objekte që bashkëjetojnë me privacy-n dhe banesën tonë të brendshme.

Është e çuditshme se si ato mund të luajnë një rol krejtësisht të ndryshëm.

Delikatesa, butësia dhe naiviteti, papritmas kthehen e bëhen fuqia e tyre.

Fuqia e tyre emfatizohet prej kontrastit të fuqishëm me fasadat agresive.

Tingëllon e çuditshme, por ato "ruajnë" një ndërtesë duke përdorur vetëm pamjen e tyre të jashtme. Menjëherë ato kthehen në "kukulla roje". Në këtë rast, kukullat luftojnë duke përdorur imazhin e tyre që konkuron me ndërtesën.

Të varur në këto pozicione ato bëhen talismanë. Pronarët e këtyre ndërtesave, në një farë mënyre besojnë në një fuqi negative mistike të syrit njerëzor.

Këto njerëz i varin kukullat për një arsye "serioze", për të shpërqëndruar syrin e shikuesit.

Njëfarësoj ato pranojnë se lojrat janë më tërheqëse se sa vetë ndërtesa, madje edhe pse ato mëtojnë estetikë dhe harmoni në arkitekturën e tyre.

Instalacioni (kukulla të mbuluara me beton) njëjtëson subjektivisht lëndën e ndërtesave dhe kukullave.

NERTILA PERE



Under Radiation, fotografi, 83 x 63 cm



Under Construction, fotografi, 83 x 63 cm

Under Construction Cities

Qyteti në ndërtim, është ai ku ne jetojmë, qyteti që ndryshon dita ditës. Me shumë të drejtë mund të nënkuptojmë se ndryshimi sjell zhvillimin, nëse ky mbetet një ndryshim i kujdesshëm dhe i menduar, në të kundërt do të qëndrojmë ende në gjendjen UNDER CONSTRUCTION

SARA ÇAPALIKU



Objekt, fotografi, 40 x 26,7cm



Objekt, fotografi, 40 x 60 cm

"Objekte" janë pjesë e një kërkimi reportazhesk, por që vijnë dhe shkëputen prej kontekstit urban apo pejsazhit ku ata gjenden, duke dashur të "gërmohen" në vetvete dhe të shumëkuptimësohen.

SIDI KANANI



Pa titull, vaj në kanavace, 90 x 70 cm

Pikturat paraqesin momente të cilat përmbajnë nota romantizmi të përzier me nostalgji, aty ku zakonisht nuk pret që t'i gjejmë. Gati si të braktitura dhe jashtë vëmendjes, një tabelë ose një poç ndriçues në rrugë shndërrohen në pika ndalimi për të medituar dhe ndoshta analizuar mbi çështje të jetës sonë urbane.

THEODHORAQ NAPOLONI



Ikona e MSN në trajtë martesë, 100x75cm
akrilik dhe vaj në kanavacë, 2009



Furçat, 2010, 113 x 60 cm
akrilik dhe vaj në kanavacë

Përgjithësisht, praktika ime orientohet kah piktura. Në thelb pikturat portretizojnë situata teatrale të krijuara nga objektet. Një dukje formale dhe estetike e objektit që ato paraqesin dhe që kanë cilësitë e "realizmit fiktiv".

Ajo çka më intereson më tepër mua është shprehja e situatave që kanë të bëjnë me pavetëdijen dhe është pikërisht pavetëdija që i jep aq rëndësi anës instinktive dhe më shtyn mua kah disa veprime ose tërheq vëmendjen time drejt diçkaje. Gjatë fazës së realizimit të pikturës, "ky interes i veçantë" bëhet edhe më i fortë dhe i jep imazheve një qartësi më të dukshme me të gjitha detajet dhe karakteristikat e objektit.

Natyra e objekteve që bëhen pjesë e pikturës është e ndryshme. Ndonjëherë imazhet përfundimtare tingëllojnë si të pakuptimta. Natyra e tyre është shumë e afërt me mua dhe i përket përvojave të mija personale e komplekse të frikës, ëndjes, surprizës, çudisë, etj.

ARJAN SERJANAJ

Lindur në Tiranë, Shqipëri, 1982.

Edukimi: 2003 – 2009, Accademia delle Belle Arti di Bologna.

Aktualisht specializim në akademinë e Arteve të Bukura të Bolonjës.

Jeton dhe punon në Bologna që prej 2003.

Ekspozita:

2006 “Primo premio internazionale arte laguna”, Mogliano – Veneto, Itali

ERVIN BEXOLLI

Lindur në Tiranë në 1984.

Në 2007 u diplomua ne Akademinë e Arteve, Tiranë (pikturë monumentale).

Jeton dhe punon në Tiranë.

Ekspozita:

2009 - “Holocen”

2009 - “Onufri” Galeria Kombëtare e Arteve

2008 - “Marubi 08” Galeria Kombëtare e Arteve

2007 - “Pinholle” prane Galeria e vogel, Tiranë

2006 - “Changes” Lind-Art, Workshop dhe ekspozite.

LEDIA KOSTANDINI

Lindur në Pogradec në 1983.

Edukimi: 2002 – 2006, Akademia e Arteve , Tiranë (pikturë monumentale).

Jeton dhe punon në Tiranë.

Ekspozita

2002 - Ekspozita e parë personale me 100 piktura/grafika. Pogradec.

2003 - Ekspozitë, me tre artistë të tjerë në Galerinë e Arteve, Pogradec.

2008 - my space 07. Tirana-Berlin, Galeria e Akademisë së arteve Tiranë.

2008 - my space 03. Tirana-Berlin, Haus am Loitzowplatz, Berlin, Gjermani.

2009 - Feedback Tirana-Berlin. Hotel Dajti, Tiranë.

2009 - Jeune Creation. Galeri 104, Paris, Francë.

2010 -«Squat the city » Olympia Center. Tiranë.

2010 -“Ardhje”, Zeta Galeri, Tiranë (cmimi i dytë).

2010 - “A diary in Photos/ Berlin-Tirana” , Galeria e Artit, Pogradec.

2010 - “A diary in Photos/ Berlin-Tirana” , Qendra TEN, Tiranë.

2005 - 2010 është pjesëmarrëse në ekspozitën e përvitshme “Nëntori”.

NERTILA PERE

Lindur në Tiranë në 1986.

Edukimi: 2004-2008, Akademia e Arteve, Tiranë-dega pikturë.

Ekspozita:

2007 - Gothenburg – Sweden - “ Reworking Dissent”

Pjesmarrje në grup ne hapjen e Bienales se Gotheborgut, Suedi. Gjithashtu workshop dhe ekspozite

me studentë të arteve nga Konsthogoskolan Valand Academy of Arts (Gothenburg),

Carrara Academy of Arts (Bergamo) dhe Akademia e Arteve e Tiranës. Gallery Rotor. (25.8-16.9).

2007 - “A State of Change” Interactive Media Workshop with Performing Pictures,

me Geska Helena Andersson & Robert Brecevic nga “ Interatcive Institute” ne Stockholm.

2009 - “Ardhje 2009 “. Ekspozita u organizua ne te njejten kohe me Bienalen e Tiranës–shtator 2009.

2010 - Pjese e seksionit shqiptar ne “ The International Video Art Festival “ ,Trieste, Italy. 21.1 -28.9) .

2010 – Ekspozita “Konkurs nderkombetar I fotografise” nga Konsullata Italiane e Vlores, 30 prill (çm. III).

2010 – Ekspozite konkurs I fotografise “ENEL”. (maj-prill), çmim promocional.

2010 - Open Studios, aktiviteti I pare I “Tirana Art LAB”, nje nga 20 artistet pjesmarres,(21-23 maj).

SARA ÇAPALIKU

Lindur ne Shkoder me 1992.

Studente e Fakultetit te Drejtesise në Tirane, ku edhe banon.

Ne vitin 2010 ka botuar albumin fotografik "Rruges".

THEODHORAQ NAPOLONI

Lindur në 1991

Edukimi: 1999 – 2003. Akademia e Arteve te Bukura,Tirane(dega piktore).

Ekspozitat:

2003 "Vangjush Mio", Galeria "Guri Madhi ", Korçë, Shqiperi.

2003 Onufri 2003,GKA, Tiranë, Shqiperi.

2005 "Vangjush Mio", Galeria"Guri Madhi", Korcë, Shqiperi.

2006 Saze on Tour, Mariakapel Gallery, Hoom, Netherland

2006 "Vangjush Mio", Galeria"Guri Madhi", Korcë, Shqiperi.

2007 "Ardhje", Galeria FAP, Tiranë, Shqiperi .

2007 "Vangjush Mio", Galeria"Guri Madhi", Korcë, Shqiperi.

2009 'Start' exhibition at "National Museum Of Medieval Art"

Honors and Awards

2003 Ekspozita "Start", ne Galerine e Akademise se Arteve,Tirane (fitues çmimit te III-te).

GEDMOND LUSHKA

Aktualisht jeton e punon ne Itali.

SIDI KANANI

Lindur ne Shkoder në 1979.

Edukimi: 1997-2001. Akademia e Arteve, Tiranë (dega piktore).

Jeton dhe punon në Shkoder.

Ekspozitat:

2004- Ekspozitë personale në Shkodër.

2005 – Ekspozitë kolektive me temë:" Vështrimi nuk i lë gjërat të pandryshuara"
,Galeria e Arteve, Shkodër.

2007 - Ekspozite me artistë ndërkombëtarë me temë "Pranverë 2(007)" në
Tiranë.2007 - Rezident në TICA (Instituti i Artit Bashkëkohor Tiranë).

2007 - Ekspozitë kombëtare me temë : " Shqipëria një rievokim " , Galeria e
Arteve, Shkodër.


2007 - Ekspozitë kombëtare me temë: " Salloni i vjeshtës ",GA Shkoder.

2009 – Ekspozita kombetare "Salloni i vjeshtës",GA Shkodër.

2007-2010 - Ekspozitë me mësuesit e shkollës së mesme artistike"Prenk Jakova".GA
Shkoder.

romeno

Çmimi
IDROMENO



Konkurs kombëtar i arteve pamore për artistët e rinj